

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shpopullimi/ Në Grykë-Çajë të Kukësit mbeten 90 nxënës nga 500 që ishin deri në vitet 2000! Rruga pa asfalt, shteti nuk siguron transport për mësuesit - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/shpopullimi-bie-numri-i-nxenesve-ne-grykecaje-te-kukesit-num-erohen-vetem-90-rruga-pa-asfalt-shteti-nuk-siguron-transport-per-mesuesit-1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:26:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:24:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f66c0156488d0ea03beb1acf9eefdd31fcaa4e0f96213f81444c00e0464946c1
TEKSTI	937a01524a448b76f1b647282c446b9bfeaad9e5ad8c6d986fd313e8d1c20929
PAMJA	815193516560063dc08ae1c3564226a477f7ff9c1956e9bef10fa63ded899b32

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	70a4418aae573e06fec1358a19477044fe2a782c4dfc40cdecdaeca8db53180c
E MËPARSHMJA	1be5f65f62769fd049ce47c338762c38d7a46524866c2ca43a257595e3e1881b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/70a4418aae573e06fec1358a19477044fe2a782c4dfc40cdecdaeca8db53180c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Humbi kontrollin e motorit dhe u përplas me një shtyllë, ndërron jetë 21-vjeçari në Cërrik! Plagoset i mituri



Sociale

Shpopullimi/ Në Grykë-Çajë të Kukësit mbeten 90 nxënës nga 500 që ishin deri në vitet 2000! Rruga pa asfalt, shteti nuk siguron transport për mësuesit

Në njësinë administrative Grykë-Çajë të Kukësit, numri i nxënësve ka rënë ndjeshëm për shkak të emigrimit. Sot kanë mbetur 90 nxënës nga 500 që numëroheshin deri në vitet 2000. Një tjetër problem është se mësuesve nuk u sigurohet transporti. Ndërsa rruga është e paasfaltuar, në terren të vështirë malor.



Benet Beqiri

27 Shtator, 15:21 | Përditësimi: 27 Shtator, 15:49

Share Tweet

A A

KUKËS - Rreth 30 kilometra larg qytetit të Kukësit, rruga me kthesa mes maleve të çon drejt fshatit me emrin unik "Fshat", në njësinë vendore **Grykë-Çajë**. Peizazhi është mahnitës por pas kësaj bukurie fshihet një realitet i trishtë.

6 kilometrat e fundit, nga aksi nacional Kukës-Bushtricë e deri te shkolla janë të paasfaltuara. Në dimër bëhet e rrezikshme prej ngricave.

Në shkollën 9-vjeçare "Isuf Seferi", nxënësit zhvillojnë mësimin në klasa kolektive.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:
Gjirokastra, qarku 'më i plakur', Kukësi 'më i riu'! Rritet mosha mediane, gratë me diferencë nga burrat

"Kjo është shkolla qendër kemi dhe tre shkolla varëse. Këtu ka afërsisht 33 **nxënës** i kemi klasa të bashkuara në klasa kolektive ka vite që vazhdon kjo punë për shkak të numrit nxënësve edhe shkollat vartëse kanë nga 25-30 nxënës domethënë gjithsej kemi 90 nxënës", tha **Betim Lushi**, drejtor i shkollës.

Deri në vitet 2000, numëronte rreth 500 nxënës, pasi ishte shkollë 9-vjeçare dhe e mesme.

"Më parë kjo ka qenë shkollë e mesme. Kanë qenë 300 nxënës deri në 500 nxënës, deri në vitet 2000. Tani nxënësit pasi mbarojnë shkollën 9-vjeçare shkojnë në shkollën e mesme të Bushtricës ose në Kukës, në Tiranë e të tjerë", u shpreh Lushi, më tej.

Braktisja është pasojë e disa faktorëve, që nga lëvizjet demografike, problemet sociale e deri te mungesa e infrastrukturës.

"Banorët kanë ikur në zona urbane por edhe jashtë shtetit kanë ikur për shkak të një jetese më të mirë që të kanë kërkuar për një jetesë më të mirë. Por si zonë e thellë është zona e Grykë-Çajit që ka më shumë nxënës nga të gjithë zonat e thella, më shumë banorë edhe nxënës. Rënia e nxënësve është edhe për shkak të të problemeve sociale, sepse sot nuk po martohen të rinjtë, kanë ikur të rinjtë jashtë dhe në qoftë se s'martohen edhe nxënësit bien normalisht. Edhe infrastruktura ndikon, pra rruga se gjithmonë është bërë kërkesë, por shpresojmë që të rregullohet e të bëhet me asfalt", thekson drejtori, Betim Lushi.

Këtu shërbejnë disa arsimtarë por sakrificën më të madhe e bën mësuesi i historisë, **Bledar Tota**. Prej 5 vitesh udhëton nga Kukësi në Grykë-Çaj me makinën personale. Shteti nuk i mbulon shpenzimet e transportit.

"Vështirësitë janë goxha të mëdhaja se vij vetëm cdo ditë nga qyteti i Kukësit. Kam vështirësi se jam shumë larg dhe shteti nuk mundëson transport. Shpenzimet që i mbuloj pothuajse të gjitha vetë. Realisht transporti është shumë i vështirë sidomos në periudhën e



umini që është umerresim e rreziksimi por është pasioni, është dëshira, është kjo është që më ka mbajtur këtu", u shpreh Bledar Tota, mësues.

E ardhmja e arsimit në Grykë-Çajë është në pikëpyetje, pasi numri i nxënësve çdo vit është në rënie, ndërsa banorët e mësuesit kërkojnë së paku të asfaltohet rruga.

Xh.K/R.D/Shqiptarja.com

TAG: [Betim Lushi](#) [shpopullimi](#) [nxenes](#) [Kukes](#) [gryke-çaje](#) [Bledar Tota](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente

© Ndalohej reprintsisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

26 Shtator, 18:15

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Dimri 'troket' që në shtator, dëbora zbardh bjeshkët e Tropojës (VIDEO)

26 Shtator, 10:18



Reshje të dendura shiu në Kukës, bien djeshëm temperaturat! Në zona të caktuara rrezikohet rënia e gurëve dhe rrëshqitja e dherave

25 Shtator, 15:24



Sherr mes nxënësve në gjimnazin e Krumës, 17-vjeçari gërvisht me mjet prerës shokun e klasës

22 Shtator, 15:03



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

20 Shtator, 11:31



SPECIALE/ Ervin Demushi ndërton të ardhmen në Alpe, historia e të riut që refuzoi emigrimin për të rikthyer traditën e të parëve

 Benet Beqiri

20 Shtator, 10:57



'Eliani i vogël pret mësuesen të rruga e malit', drejt mbylljes shkolla me histori 82-vjeçare në Seničan të Këlcyrës! Sot kanë mbetur vetëm 3 nxënës

 Piro Nase

16 Shtator, 15:01



Shpopullimi/ Vetëm 5 nxënës në shkollën e Linajt në Malësi të Madhe! Asnjë fëmijë në ciklin fillor, emigracioni boshatis klasat

 Ergys Kavaja

15 Shtator, 14:41



Pagat e magjistratëve/ Bojkoti në Gjykatën e Kukësit lë qytetarët pa shërbime: Po tallen me ne, a ka shtet apo s'ka shtet?

 Benet Beqiri

15 Shtator, 13:03



PD: 1.1 mln shqiptarë u larguan drejt BE-së në 18 vite! 30 mijë nxënës më pak në 3 vite, shkollat po mbylleen (VIDEO)

15 Shtator, 12:07



Bie numri i nxënësve në disa qytete, shkollat e fshatrave drejt mbylljes! Surprizon Lushnja, regjistron afro 300 nxënës më shumë se vjet

14 Shtator, 16:29



Reshjet e shiut nuk pengojnë qytetarët e Kosovës të kalojnë fundjavën në Shqipëri! Fluks në Morinë (VIDEO)

12 Shtator, 16:57



Drejtori i shërbimeve publike dhe drejtuesi teknik i punimeve u ndaluan pas vdekjes së punonjësit të bashkisë së Tropojës, nis hetimi për dy zyrtarët

10 Shtator, 11:02

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.